



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 korrik 2013
Nr.ref.:RK432/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI60/13

Parashtrues

Bujar Shatri

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së procedurës së rregullt gjyqësore kundër
Bujar Shatri**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Bujar Shatri (në tekstin e mëtejme: parashtruesi), me vendbanim në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston procedurën e rregullt gjyqësore kundër tij, e iniciuar nga prokurori publik komunal me aktakuzën e 12 nëntorit 2008 dhe vendimin gjyqësor pasues që është nxjerrë.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se, *“neni 36, pika 3 e Kushtetutës, neni 12 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe neni 8 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut janë shkelur në procedurën e rregullt gjyqësore kundër parashtruesit, z. Bujar Shatri, nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Vendimin Ap. nr. 159/2011, të 28 dhjetorit 2011 si dhe nga Prokurori i Shtetit”*.
4. Për më tepër, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të mos zbulohet identiteti i tij, sepse ai është person zyrtar.

Baza ligjore

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 18 prill 2013, Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 29 prill 2013, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin Nr. GJR. KI-60/13, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, nr. KSH. KI-60/13, caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.
8. Më 14 maj 2013, kërkesa iu komunikua Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Zyrës së Prokurorit të Shtetit.
9. Më 19 qershor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 25 janar 2008, Shërbimi i Doganave të UNMIK-ut dorëzoi një kërkesë në Polici për t'i hetuar veprat penale të kryera nga zyrtarët e doganës. Inicimi i këtij rasti është bërë si rezultat i dyshimeve që kanë dalë nga përgjimet e telekomunikimeve në një rast tjetër penal.

11. Më 11 shtator 2008, Policia i dorëzoi prokurorit publik të qarkut kallëzimin penal, përveç të tjerëve, edhe kundër parashtruesit, për shkak të dyshimit se ka kryer veprë penale nga neni 339 (shpërdorimi i detyrës zyrtare ose autorizimit), neni 25 (ndihma) dhe neni 304 (moslajmërimi i veprave penale apo moslajmërimi i kryesit të saj) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK).
12. Më 12 nëntor 2008, prokurori publik komunal ngriti aktakuzë (5710-15/2008) në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër parashtruesit për kryerjen e veprës penale nga neni 304 (moslajmërimi i veprave penale apo moslajmërimi i kryesit të saj) të KPPK-së.
13. Më 10 shkurt 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë e vërtetoi aktakuzën e prokurorit publik komunal (Vendimi KA. Nr. 394/08).
14. Më 29 mars 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Vendimi P. nr. 496/2009) nxori vendimin për pranueshmërinë dhe papranueshmërinë e provave.
15. Më 16 maj 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi P. nr. 496/2009) e liroi parashtruesin nga akuza penale, sepse akuza penale nuk ishte mbështetur nga asnjë provë.
16. Më 14 qershor 2011, prokurori publik komunal ushtori ankesë në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë të 16 majit 2011 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
17. Më 28 dhjetor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Vendimi Ap. nr. 159/2011) e aprovoi ankesën e prokurorit publik komunal dhe e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 16 majit 2011 dhe e ktheu rastin në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për rigjykim. Gjykata e Qarkut në Prishtinë gjeti se *“aktgjykimi i kundërshtuar për tani është i paqëndrueshëm ngase përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuara me nenin 403 par. 1 pika 12 të Kodit të përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës [...] sepse nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, arsyet e dhëna janë të paqarta, ndërsa konkludimi i Gjykatës së shkallës së parë në bazë të provave të administruara dhe provave të cilat ajo i ka shpallur të papranueshme, tani për tani nuk është i qëndrueshëm.”*
18. Më 17 shtator 2012, parashtruesi i kishte dërguar letër Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, duke u ankuar se të drejtat e tij të njeriut dhe liritë ishin shkelur ngase Gjykata e Qarkut në Prishtinë, *“[...] një koleg gjyqtarësh e merr një vendim të kundërligjshëm, duke i shpallur si të pranueshme transkriptet me përmbajtjen e SMS-ve, që konsiderohen si komunikim telefonik, ndërsa mungon një urdhër gjyqësor i gjyqtarit të procedurës paraprake për masën e “përgjimit të telekomunikimit” nga neni 258 paragrafi 2 nën para. 4 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës. Është mjaft e qartë sipas ligjit të zbatueshëm se përmbajtja e porositve telefonike (SMS) nuk mund të konsiderohet si e përfshirë në “regjistrin e thirrjeve telefonike dhe sms-ve”. Përmbajtja e SMS-ve konsiderohet si komunikim, përgjimi i së cilës kërkon marrjen e një urdhri*

gjyqësor sipas nenit 258 paragrafi 2 nën paragrafin 4 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës. Ky vendim gjyqësor është në kundërshtim të plotë me Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës, sepse me nenin 36 pika 3 e Kushtetutës është e garantuar e drejta e privatësisë së individit, citoj: “Fshehtësia e korrespondencës, e telefonisë dhe e komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.” Për të qenë shkelja edhe më drastike në dosjen e lëndës përveç se mungon urdhri gjyqësor i gjyqtarit të procedurës paraprake, në shkresat e lëndës për muame vendbanim në Prizren, nuk ka asnjë urdhëresë për regjistrim të thirrjeve telefonike dhe sms-ve as nga prokurori i rastit, gjë që rrit edhe më shumë shqetësimin tim për përgjim joligjor të komunikimit dhe cenim të privatësisë.”

19. Më 18 shtator 2012, Kryetari i Gjykatës Supreme iu përgjigj parashtruesit, duke deklaruar se “[...] tani ne si Gjykatë Supreme nuk mundemi as të ndërhyjmë dhe as të komentojmë vendimet gjyqësore të instancave më të ulëta. [...] por duhet pritur përfundimin e procedurave gjyqësore, të cilat për momentin janë në pritje.”
20. Më 25 tetor 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi P. nr. 1786/2012) në rigjykim e liroi parashtruesin nga akuza penale, sepse akuza penale nuk ishte mbështetur nga asnjë provë. Parashtruesi pretendon se ky aktgjykim mori formën e prerë më 18 dhjetor 2012.
21. Për më tepër, asnjë dokument përcjellës nuk ishte dorëzuar në lidhje me arsyet e parashtruesit që mos të zbulohet identiteti i tij.

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi pretendon se, “Në dosjen e lëndës penale që është mbyllur me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 18 dhjetorit 2012, duke marrë formën e prerë me 18.12.2012, mungon urdhri gjyqësor i gjyqtarit të procedurës paraprake, respektivisht, urdhri për përgjimin e thirrjeve telefonike dhe SMS-ve, gjë që çon në shkeljen e privatësisë së individit përmes përgjimit joligjor të komunikimit, e drejtë kjo e garantuar me nenin 36 të Kushtetutës së Kosovës”.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregulloren e punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 113.1 dhe neni 113.7 të Kushtetutës parashohin:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. (...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.“

dhe neni 47.2 i Ligjit, i cili parasheh: “Individi mund ta ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

25. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterë të gjitha mundësitë procedurale në procedura të rregullta për ta parandaluar shkeljen e Kushtetutës, ose, nëse ka, për ta korrigjuar shkeljen e një të drejte themelore.
26. Gjykata thekson se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua lejojë autoriteteve, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e domosdoshme që të drejtat kushtetuese të ngrihen në mënyrë eksplicite në procedurat e përmendura. Edhe nëse çështja është ngritur në mënyrë implicite apo në substancë, kushti i shterjes së mjeteve do të jetë përmbushur (shih, *mutatis mutandis*, ECHR, Azinas kundër Qipros, nr. 56679/00, vendim i 28 prillit 2004).
27. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi ka një Aktgjykim të favorshëm nga Gjykata Komunale e Prishtinës, duke e liruar atë nga akuza penale. Megjithatë, parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese të sjellë një vendim nëse është shkelur e drejta e privatësisë së parashtruesit. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka ndjekur mjetet ligjore në dispozicion për shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij për privatësi.
28. Prandaj, parashtruesi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjeve në fuqi, siç kërkohet nga neni 113.7 i Kushtetutës dhe neni 47.2 i Ligjit.
29. Sa i përket kërkesës për moszbulimin e identitetit të tij, Gjykata e refuzon atë si të pabazuar, sepse nuk ishte ofruar asnjë dokument përcjellës dhe informatë për arsyet e moszbulimit të identitetit të tij.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 4 korrik 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën e parashtruesit për moszbulim të identitetit të tij;
- III. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,
- V. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani